



bashkeendreqim

UnitedAgainstCorruption # KS

**JAVA KUNDËR KORRUPSIONIT
5-9 DHJETOR 2016**



**JAVA KUNDËR KORRUPSIONIT
5-9 DHJETOR 2016**

bashkeendreqim

UnitedAgainstCorruption # KS

#KDI

#Çohu

#D+

#GLPS

#IKD

#GAP




E HËNË, 5 DHJETOR 2016

#01

TAKIM MËNGJESI ME MEDIA

ORA: 9:30 - 10:30

VENDI: HOTEL "SIRIUS"



Ngjarje informuese për media ku lansohet Java Kundër-korrupsionit dhe shpalosen aktivitetet që do të zhvillohen nga koalicioni i organizatave joqeveritare në kuadër të Javës Kundër Korrupsion 5-9 Dhjetor 2016 me moton "Bashkeendreqim".

Mediave do t'u drejtohen përfaqësues të koalicionit dhe Ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Z. Greg Delawie.

#KDI

E HËNË, 5 DHJETOR 2016




#02

LUFTIMI I KORRUPSIONIT PËRMES TRANSPARENCËS BUXHETORE DHE RISHIKIMIT TË RAPORTEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

ORA: 11:00 - 12:30

VENDI: HOTEL "SIRIUS"



Tryezë diskutimi me temën "Luftimi i korrupsionit përmes transparencës buxhetore dhe rishikimit të raporteve të Auditorit të Përgjithshëm". Si i shpenzon shteti parat tona? Si të parandalohet abuzimi me paratë publike dhe të rritet transparenca e shpenzimit të paratë publike? Si të zvogëlohen shpenzimet e panevojshme dhe të parandalohet keq-menaxhimi i buxhetit të shtetit?

#InstitutiGAP

E MARTË, 6 DHJETOR 2016




#03



MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT DHE POLITIKAVE NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

ORA: 10:00 - 12:00

VENDI: HOTEL
"SIRIUS"



Tryezë diskutimi për "Mbiqëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe politikave në luftimin e korrupsionit". IKD gjatë kësaj tryeze do të prezantoj edhe raportin e monitorimit të rasteve të korrupsionit në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, i cili i referohet periudhës tre mujore korrik, gusht, shtator 2016. Në këtë tryezë do të ftohen Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe të gjithë Kryetarët e Gjykatave dhe të gjithë Kryeprokurorët e Prokurorive. Në tryezë do të diskutohet për performancën e prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e legjislacionit dhe politikave të Këshillave në luftimin e korrupsionit. Sa po zbatohen obligimet ligjore për trajtimin e rasteve të korrupsionit? A ka probleme me legjislacionin e aplikueshëm në luftimin e korrupsionit? Çfarë politikash kanë miratuar Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial në luftimin e korrupsionit? Sa po zbatohen këto politika në praktikë? Sa ka transparencë dhe llogaridhënie për zbatimin e obligimeve ligjore dhe këtyre politikave në luftimin e korrupsionit?

#IKD

E MARTË, 6 DHJETOR 2016




#05

PERFORMANCË E KOALICIONIT TË OJQ-VE PARA PALLATIT TË DREJTËSISË: “DËSHTIMET NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT”

ORA: 14:00

VENDI: PALLATI I
DREJTËSISË




Koalicioni i OJQ-ve do të shpalos 10 banerë, të cilët përmbajnë fakte dhe mesazhe për luftën kundër korrupsionit bazuar në gjetjet e monitorimit sistematik të sistemit të drejtësisë.

#IKD, #KDI, #GAP, #GLPS

E MËRKURË, 7 DHJETOR 2016




#06



INTEGRITETI DHE FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE

ORA: 10:00 - 12:00

VENDI: HOTEL "SIRIUS"



Tryezë diskutimi për "Transparencën e Financimit të Subjekteve Politike". Sa po zbatohet legjislacioni i financimit dhe kontrollit të financave të subjekteve politike? A ka mekanizma dhe vullnet të mjaftueshëm institucional për të kontrolluar fondet e subjekteve politike? A është auditimi i raporteve kusht për të pasur transparencë? Çfarë po ndodhë me auditimin e financave të partive politike?

#KDI, #Çohu, #D+, #GLPS

E MËRKURË, 7 DHJETOR 2016




#07

DËGJIM PUBLIK PËR PROGRESIN E INSTITUCIONEVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

ORA: 13:00 - 14:00

VENDI: KUVENDI I
KOSOVËS

#Komisioni #GLPS,
#KDI, #Çohu



Dëgjim Publik i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me progresin e institucioneve të Kosovës në luftën kundër korrupsionit. Cilat janë hapat konkret të institucioneve të Kosovës në luftën kundër korrupsionit?

Cilat janë sfidat e hasura nga institucionet në luftimin e kësaj dukurie? A ka bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e korrupsionit në Kosovë?

E ENJTE, 8 DHJETOR 2016




#08

STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

ORA: 10:00 - 12:00


VENDI: HOTEL "SIRIUS"



Tryezë diskutimi me temë "Shkalla e zbatimit të Strategjisë kundër-Korrupsionit". Cilat janë arritjet e institucioneve të Kosovës në zbatimin e masave dhe veprimeve që rrjedhin nga kjo Strategji? Cilat janë sfidat që institucionet hasin në zbatimin adekuat të kësaj Strategjie? Kjo tryezë do të reflektojë mbi gatishmërinë institucionale në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e mekanizmave kundër-korrupsion.

#GLPS, #Çohu, #KDI

E ENJTE, 8 DHJETOR 2016




#09

DËGJIM PUBLIK PËR ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

ORA: 13:00 - 15:00

VENDI: KUVENDI I
KOSOVËS



Dëgjim Publik me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike për "Performancën e Organit Shqyrtues të Prokurimit". Sa është i paanshëm në trajtimin e ankesave të prokurimit? Çfarë plane ka bordi i ri i OSHP-së për të kthyer besimin e opinionit dhe operatorëve ekonomik? A ka transparencë të mjaftueshme në vendimmarrje dhe shqyrtim të ankesave? Çfarë masa janë marr për të vlerësuar rreziqet dhe parandaluar korrupsionin në OSHP?

#Komisioni, #D+


E PREMTE, 9 DHJETOR 2016



#10

KONFERENCË PËR MEDIA

ORA: 10:00
VENDI: PËRBALLË
TEATRIT
KOMBËTAR,
PRISHTINË



KDI mbanë konferencë për media ku do të prezantojë përmbledhjen e arritjeve dhe sfidat e mbetura të institucioneve të Kosovës si dhe raportimet e korrupsionit nga qytetarët në linjën 0800 77 777.

#KDI


E PREMTE, 9 DHJETOR 2016

#11

EKSPOZITË

ORA: 18:00



VENDI: UNION CAFFE



KDI dhe UNDP organizojnë ekspozitën me fotografi ku do të prezantojnë fituesit dhe fotot që kanë garuar në rrjete sociale me hashtag #hanhankorrupsioni

#KDI #UNDP

E PREMTE, 9 DHJETOR 2016




#12

KONCERT ME “TROJA”

ORA: 20:00 - 22:00

VENDI: SHESHI ZAHIR
PAJAZITI



D+ organizon koncert me bendin muzikor “Troja”, qëllimi i së cilës është të përcillen mesazhe kundër korrupsion për qytetarët të cilët do të marrin pjesë në këtë koncert. Koncerti do të transmetohet ‘live’ nga të paktën një televizion kombëtar.

#D+



5-9 DHJETOR

HUMAN: 6 radio lokale (Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Gjakovë) do të zhvillojnë intervista me zyrtarë të ambasadës amerikane për temat që lidhen me luftimin e korrupsionit. Intervistat zhvillohen prej 5-9 maj.

Radio FONTANA, Istog

TOP ILIRIA RADIO, Deçan

Radio Gorazdevac, Pejë

Radio PEJA, Pejë

Radio Gjakova

Radio Alba, Klinë


E ENJTE, 8 DHJETOR

KOSOVO UNITED STATES ALUMNI KUSA:

Prezantimi i raportit në Komunën e Prishtinës

E PREMTE, 9 DHJETOR;


12:00-13:00
SALLA ORION



**QENDRA PËR STUDIME TË
AVANCUARA FIT:** organizon diskutime
me nxënësit e tetë shkollave nga katër
komuna (Viti, Prizren, Obiliq, Vushtrri)
me temën “Roli i të rinjve në luftimin e
korrupsionit”

E PREMTE, 9 DHJETOR

13:00-17:00
SIRIUS HOTEL



**KOSOVO BAR ASSOCIATION
(KBA) DHE INL-FUNDED DEMAND
FOR JUSTICE PROGRAM:**
Tryezë e Shoqërisë Civile në Ditën
Kundër Korrupsionit.



#bashkeendreqim



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



KOSOVA
DEMOCRATIC
INSTITUTE

Koalicioni i organizatave joqeveritare për "Javën Kundër Korrupsionit" i përbërë nga Çohu, Demokraci Plus (D+), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti GAP dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me përkrahje të Ambasadës Amerikane në Kosovë, organizojnë aktivitetet në këtë katalog në kuadër të shënimit të Javës Kundër Korrupsionit.